


Filtër-Vrojtues Diellor: Udhëzime Përdorimi



Eklipsi i plotë i Diellit

E Hënë, 8 Prill 2024



TERMS AND CONDITIONS FOR USE OF ECLIPSE GLASSES

Please read these Instructions for Use carefully before using the Eclipse Glasses. Your purchase and use of the Eclipse Glasses constitutes your agreement to these Terms and Conditions. Failure to follow these Instructions for Use may result in serious personal injury, including permanent eye damage. If you do not understand these Instructions or cannot follow them diligently and completely, then you should not look at the Sun at any time, with or without the Eclipse Glasses.

The term “Eclipse Glasses” refers to the special cardboard-and-polymer optical products, marked “SAFE FOR DIRECT SOLAR VIEWING”, manufactured by Rainbow Symphony of Reseda CA or American Paper Optics of Bartlett TN, and sold by Eclipse2024.org for the purpose of viewing the Sun during the solar eclipse of April 8, 2024, by or under the direct supervision of a person 18 years of age or above and in accordance with these Instructions for Use.

Observing the Sun directly, without the benefit of eye protection provided by the Eclipse Glasses, will likely result in serious personal injury, up to and including permanent eye damage and blindness. When these Instructions for Use are followed completely and precisely, the undamaged and unmodified Eclipse Glasses have been proven to be safe and effective in allowing direct, short-term viewing of the Sun. If these Instructions for Use are not followed, or if damaged or modified Eclipse Glasses are used, permanent eye injury could result.

You should never look directly at the Sun, with or without the aid of the Eclipse Glasses, if you have any temporary or permanent medical or other condition which either (1) prevents your use of the Eclipse Glasses according to these Instructions for Use, or (2) which predisposes you to an increased or special risk of incurring, worsening, or contributing to the effects of any optical condition, or other medical, health, or other condition, by looking or attempting to look at the Sun.

You should never attempt to perform any other activity (such as driving or walking) while using the Eclipse Glasses.

You agree that if you allow others to use the Eclipse Glasses, you will provide each such user with a copy of these Instructions for Use and will make sure such user reads and understands the Instructions for Use before using the Eclipse Glasses.

By using the Eclipse Glasses to view the Sun, you agree with the following:

- (a) you understand these Instructions for Use completely;
- (b) you understand and accept the risks associated with improper use of the Eclipse Glasses;
- (c) you accept full responsibility for, and assume all risks associated with, the act of viewing the Sun, with or without the use of the Eclipse Glasses; and
- (d) the Eclipse Glasses are fragile, and any damage or modification will render them immediately and permanently unusable for their intended purpose.

Release and Limitation of Liability

By way of purchasing and using the Eclipse Glasses, you are irrevocably releasing, indemnifying, and holding harmless the manufacturer and seller from any liability, loss, claim and expense (including attorney’s fees), including but not limited to bodily injury or other personal harm, which may result from using the Eclipse Glasses under any circumstances or conditions and irrespective of jurisdiction. Neither the manufacturer nor the seller will be responsible for any damages of any kind, irrespective of reasons, conditions or circumstances, including malfunctioning of the Eclipse Glasses. All risks associated with using the Eclipse Glasses rest solely and entirely with the user, irrespective of whether the Eclipse Glasses are used by the original purchaser or any third party. You fully understand and assume the risks in using the Eclipse Glasses. You confirm that you have read this release of liability and fully understand its terms and that you have given up substantial rights by purchasing and using the Eclipse Glasses.

THE MANUFACTURER AND SELLER OF THE ECLIPSE GLASSES MAKE NO WARRANTY OF ANY KIND, EXPRESSED OR IMPLIED, WITH RESPECT TO THE ECLIPSE GLASSES, INCLUDING BUT NOT LIMITED TO THE IMPLIED WARRANTIES OF MERCHANTABILITY, FITNESS FOR A PARTICULAR PURPOSE, AND NON-INFRINGEMENT. NEITHER THE MANUFACTURER NOR THE SELLER SHALL BE LIABLE FOR ANY OTHER DAMAGES, INCLUDING BUT NOT LIMITED TO DIRECT, INDIRECT, INCIDENTAL, SPECIAL, CONSEQUENTIAL, OR EXEMPLARY DAMAGES, WHETHER IN AN ACTION IN CONTRACT OR TORT (INCLUDING NEGLIGENCE AND STRICT LIABILITY), SUCH AS, BUT NOT LIMITED TO, LOSS OF ANTICIPATED PROFITS OR BENEFITS RESULTING FROM, OR ARISING OUT OF, OR IN CONNECTION WITH THE USE OR FURNISHING OF THE ECLIPSE GLASSES OR THE PERFORMANCE, USE OR INABILITY TO USE THE SAME, EVEN IF THE MANUFACTURER OR SELLER HAS BEEN ADVISED OF THE POSSIBILITY OF SUCH DAMAGES. IN NO EVENT WILL THE MANUFACTURER’S OR SELLER’S TOTAL LIABILITY EXCEED THE PRICE PAID FOR THE PRODUCT.

Note Regarding Translations

[Translations](#) of these Instructions for Use into various languages are provided “AS-IS” and solely for the convenience of the reader. Eclipse2024.org has made reasonable efforts to ensure the accuracy of the Translations; however, in the event of any perceived discrepancy in meaning or interpretation between the English version and any Translation, the English version will prevail. You should not act in reliance on anything contained in any Translation of these Instructions for Use, but should refer to the official English version.


EKLIPSI I PLOTË I DIELLIT – 8 PRILL 2024

Mirë se vini në Amerikën e Veriut!

Është një nder për ne që zgjidhet të vizitonit vendin tonë për të vrojtuar eklipsin e plotë të diellit dhe ne do të donim që çdo kush të mund ta ndiqte këtë eveniment madhështor në mënyrë të sigurtë!

Versioni në Anglisht i këtyre udhëzimeve, drejtimeve, këshillave si dhe mohimeve të përgjegjësive („Udhëzimet“), është burimi zyrtar dhe i plotë i informacionit dhe udhëzuesit për përdorimin e duhur dhe të saktë të Filtër-Vrojtuesit Diellor, që ju nevojitet për të vështruar drejt Diellit. Udhëzimet mund t’i gjeni në faqen <https://tinyurl.com/2024Instructions>. Ju duhet t’i lexoni, kuptoni dhe ndiqni me përpikmëri ato. **Mosndjekja e Udhëzimeve mund të shkaktojë dëmtime serioze.**

Astronomët e quajnë eklipsin e datës 8 Prill 2024 si „eklips i plotë“, por që të shikoni plotësinë, vendndodhja juaj duhet të jetë brenda një brezi shumë të ngushtë toke e cila kalon nëpër Amerikën e Veriut (e quajtur „Zona e Plotësisë“). Do të shikoni vetëm eklips të pjesshëm nëse nuk ndodheni brenda kësaj zone! Ndaj, është shumë e rëndësishme të jeni në dijeni nëse ndodheni brenda zonës së plotësisë. Më poshtë vijon një shpjegimi i shkurtër lidhur me metodën që duhet ndjekur për vrojtimin e eklipsit.



Zona e Plotësisë

UDHËZUES HYRËS

UDHËZIME TË DETAJUARA

Termi „Filtër-Vrojtues Diellor“, sikurse është përdorur dhe në këtë dokument, përfaqëson “Eclipse Glasses”, të cilit ne i referohemi në mohimin e përgjegjësive në gjuhën angleze, të prezantuar në faqen e parë të këtij dokumenti.

Përdorimi i Filtër-Vrojtuesit Diellor përbën një marrëveshje ligjore. Duhet t’i ndiqni me përpikmëri të gjitha udhëzimet, këshillat që përmenden në udhëzues në mënyrë që ta përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor për të vëzhguar Diellin në çdo kohë. Nëse nuk i kuptoni udhëzimet, ose nëse nuk i ndiqni dot ato që të gjitha me përpikmëri, apo nëse nuk pajtoheni me kushtet e tyre, atëherë ju udhëzojmë dhe këshillojmë të mos guxoni ta vrojttoni Diellin në asnjë moment e apo mënyrë.

UDHËZUES HYRËS I FILTËR-VROJTUESIT DIELLOR

Ky Udhëzues Hyrës përmbledh [Udhëzimet e detajuara në qjuhën Shqipe](#) se si të përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor për të vështruar eklipsin, të cilat ju duhet t'i lexoni, kuptoni dhe pajtoheni me to.

- 1) Gjeni vendndodhjen tuaj te eclipse2024.org/find-times dhe zbuloni nëse eklipsi do të jetë ose jo i plotë si dhe orën e përafërt të kontaktit për fazën e pjesshme dhe atë (nëse ndodh) të plotë për atë vendndodhje.
- 2) Eklipsi i plotë i diellit është një eveniment mahnitës, të cilin ju mund ta shijoni vetëm nëse ndodheni brenda „zonës së plotësisë“, zonë kjo me një gjerësi afërsisht prej rreth 200km. Nëse plotësia është e pamundur në vendndodhjen tuaj, ne ju këshillojmë fort që të shkoni në një vend brenda zonës së plotësisë!
- 3) Për të përdorur Filtër-Vrojtuesin Diellor, puthitini mirë në sy fletët filmike të Filtër-Vrojtuesit Diellor, në mënyrë që të jeni plotësisht i sigurtë gjatë vrojtimit të drejtpërdrejtë të diellit.
- 4) Kur përdoret Filtër-Vrojtuesi Diellor për të vështruar drejt Diellit:
 - a. Nëse eklipsi **NUK ËSHTË** i plotë në vendndodhjen tuaj, atëhere duhet ta vrojtoni diellin, duke përdorur Filtër-Vrojtuesin Diellor gjatë gjithë kohës. **RREZIKON DËMTIME TË PËRHERSHME NË SY NËSE VROJTON DREJT TIJ PA MATERIALET E DUHURA MBROJTËSE!**
 - b. Nëse eklipsi **ËSHTË** i plotë në vendndodhjen tuaj, atëhere nevojitet ta vështroni diellin vetëm duke përdorur Filtër-Vrojtuesin Diellor, edhe nëse ende mund të ketë mbetur ndonjë pjesë e shndritshme e diskut të Diellit, qoftë dhe një pjesë e vogël e tij, që vazhdon të jetë e dukshme. **RREZIKONI DËMTIME TË PËRHERSHME NË SY NËSE NUK NDIQNI KËTO UDHËZIME!**
 - i. Gjithsesi, **gjatë intervalit të shkurtër të plotësisë**, ju mund ta vrojtoni drejtpërdrejt eklipsin e plotë pa përdorur Filtër-Vrojtuesin Diellor, **VETËM** nëse nuk shfaqet asnjë pjesë e shndritshme e diskut të diellit.
 - ii. Në fakt, nëse përpiqeni të përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor për të parë Diellin gjatë plotësisë, ju nuk do jeni në gjendje të shikoni asgjë!
 - iii. **DUHET** ta rivendosni në sy Filtër-Vrojtuesin Diellor menjëherë pasi faza e plotësisë ka përfunduar dhe fillon të shfaqet pjesa e shndritshme e diskut të Diellit.
- 5) Me fjalë të tjera,

KUR SHFAQET PJESA E SHNDRITSHME E DISKUT TË DIELLIT, JU DUHET TË PËRDORNI PATJETËR FILTËR-VROJTUESIN DIELLOR PËR TË PARË DREJT DIELLIT!

UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PËRDORIMIN E FILTËR-VROJTUESIT DIELLOR

Fillimisht, ju duhet të familjarizoheni me pak terminologji të fushës!

Për secilin eklips dhe vendndodhje, ka emërtime të caktuara lidhur me fazat e veçanta të eklipsit. Ato njihen si:

<i>Emërtimi i evenimentit</i>	<i>Përshkrimi i evenimentit</i>	<i>Pamja që merr (në rastin e Eklipsit të Plotë)</i>	<i>Pamja që merr (në rastin e Eklipsit të Pjeshtëm)</i>
C1	Fillimi i fazës së pjesshme		
C2	Fillimi i plotësisë		** Nuk ndodh! **
Mesi i Eklipsit	Pika qendrore e Eklipsit		
C3	Përfundimi i plotësisë		** Nuk ndodh! **
C4	Përfundimi i fazës së pjesshme		

1) UDHËZIME TË PËRGJITHSHME MBI PËRDORIMIN E FILTËR-VROJTUESIT DIELLOR



- 1) [Nëse është e zbatueshme] Nxirreni me kujdes Filtër-Vrojtuesin Diellor nga pakoja.
- 2) Ruajeni Filtër-Vrojtuesin Diellor në një vend të sigurtë, nëse nuk ju nevojiten.
- 3) Kontrolloni Filtër-Vrojtuesin Diellor përpara se ta përdorni; nëse fleta e filmit është e dëmtuar ose disi e zhubrosur, atëherë prijeni e hidheni poshtë atë dhe [merrni një tjetër të padëmtuar](#).
- 4) Nëse fleta e filmave është paksa e dëmtuar, mos e përdorni aspak Filtër-Vrojtuesin Diellor për të vrojtuar Diellin.
- 5) Mos e hiqni fletën e filmave nga Filtër-Vrojtuesi Diellor, dhe në asnjë mënyrë mos e përdorni më atë për të vështruar Diellin.
- 6) Kur fletat e filmave të Filtër-Vrojtuesit Diellor janë të ngjitura mirë dhe të padëmtuara, atëherë ato bllokohen në mënyrë të sigurtë rrezet e dritës së dukshme, rrezet e dëmshme UV (ultravjollcë), si dhe gjithë rrezet e tjera të diellit. Për këtë arsye nuk rrezikoni aspak nëse përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor sipas linjave orientuese të përshkruara në këto udhëzime për të vrojtuar Diellin në çdo kohë. Nuk ka „rreze eklipsi“ të veçanta, të cilat e bëjnë vrojtimin e diellit më shumë ose më pak të rrezikshëm gjatë një eklipsi.
- 7) **Duhet ta përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor ashtu siç përshkruhet këtu për ta vrojtuar pa rrezik Diellin, kurdo që shfaqet NDONJË pjesë e shndritshme e diskut të diellit. Kjo është e vërtetë pavarësisht çasteve të kontaktit (të emërtuara „C2“ dhe „C3“ siç përshkruhet më sipër) që ju keni regjistruar nga ndonjë burim.**
- 8) Mos e përdorni Filtër-Vrojtuesin Diellor në të njëjtën kohë me teleskopin, dylbitë, kamerën, lentet, pasqyrën apo ndonjë instrument, pajisje a objekt tjetër optic, i cili mund të transmetojë ose reflektojë dritën („pajisje optike“).
- 9) Pajisje të tilla optike, mos i drejtoni asnjëherë drejt Diellit dhe asnjëherë mos e vrojtoni drejtpërdrejt pamjen e Diellit duke përdorur ndonjë pajisje të tillë optike që është e drejtuar nga Dielli, apo që, në njëfarë mënyre, po grumbullon, fokuson, apo reflektojë dritën e Diellit.
- 10) Mos lejoni përdorimin e Filtër-Vrojtuesit Diellor nga kafshët apo nga ndonjë person me aftësi të kufizuara, i paaftë për të lexuar, kuptuar e për tu pajtuar me kushtet për përdorim në mënyrë të sigurtë Filtër-Vrojtuesin Diellor e që nuk është në gjendje të pranojë, sipas ligjit, përgjegjësitë për pasojat e veprimeve të veta.
- 11) Për të përdorur Filtër-Vrojtuesin Diellor:



Mbajeni Filtër-Vrojtuesin Diellor tërësisht të puthitur tek sytë me drejtim nga dielli dhe përmes fletës së filmit të Filtër-Vrojtuesit Diellor, duke e mbajtur Filtër-Vrojtuesin Diellor gjatë gjithë kohës ndërmjet syve dhe Diellit. Në rastin kur Filtër-Vrojtuesi Diellor ka formën e syzeve prej kartoni, atëherë palosini ato dhe veproni me Filtër-Vrojtuesin Diellor njësoj sikur të kishit syze të zakonshme. Asnjëherë mos vështroni drejt Diellit nëse ende nuk ka ndodhur eklipsi i plotë (kjo, gjatë kohës ndërmjet C2 dhe C3 siç është shënuar në tabelën e mëposhtme, nëse ato janë të zbatueshme për vendndodhjen tuaj të vrojtimin), përveç rastit kur po e vështroni direkt Diellin nëpërmjet fletëve të padëmtuara të filmave që gjenden në Filtër-Vrojtuesin Diellor.



- 12) Mos përdorni ndonjë material apo objekt tjetër për të mbrojtur sytë gjatë përpjekjeve për të vrojtuar diellin përveç fletëve të filmave të Filtër-Vrojtuesit Diellor, të vendosura brenda mbajtësve të tyre, sipas fabrikimit.
- 13) Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me këto udhëzime, ju lutemi kontaktoni Eclipse2024.org të <https://tinyurl.com/glasses-questions>.

2) MËSONI ORËT E SAKTA KUR DO NDODHI EVENIMENTI I EKLIPSIT NË VENDNDODHJEN TUAJ

Bazuar mbi informacionin e ofruar në faqen eclipse2024.org/find-times lidhur me vendndodhjen tuaj, plotëso deklaratën në vijim:

Për vendndodhjen time, eklipsi është:

I PLOTË	JO I PLOTË
----------------	-------------------















(rrethoni njëjërën)

<p>Nëse eklipsi është I PLOTË në vendndodhjen tuaj, ndiqni udhëzimet e përshkruara nën</p> <p style="text-align: center;">„EKLIPSI ËSHTË I PLOTË PËR VENDNDODHJEN TIME“</p> <p style="text-align: center;">Pjesa në vijim</p>	<p>Nëse eklipsi NUK ËSHTË I PLOTË në vendndodhjen tuaj, ndiqni udhëzimet e përshkruara nën</p> <p style="text-align: center;">„EKLIPSI NUK ËSHTË I PLOTË PËR VENDNDODHJEN TIME“</p> <p style="text-align: center;">Pjesa në vijim</p>
---	---

**** EKLIPSI ËSHTË I PLOTË PËR VENDNDODHJEN TIME ****

Ndodheni brenda zonës së plotësisë dhe do të përjetoni një eveniment të mrekullueshëm që rrallë herë ndodh! Është e rëndësishme që të dini se kur do të jetë i plotë eklipsi në vendndodhjen tuaj. Këtë mund ta mësoni duke iu referuar kohëve të shënuara më poshtë dhe kjo për arsye se nuk do të duket asnjë pjesë e shndritshme e diskut të Diellit gjatë plotësisë.

- 1) Bazuar mbi informacionin e ofruar te faja eclipse2024.org/find-times për vendndodhjen tuaj ekzakte, shënoni orët e përafërta për çdo fazë të eklipsit listuar më poshtë (sigurohuni t'i [përshtasni orët](#) me orën lokale të vendit tuaj!):

Përpara C1	* Eklipsi nuk ndodh *				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
C1	Faza e pjesshme fillon në orën:				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
C2	Faza e plotë fillon në orën:				Pas C2 , mund të vëzhgosh dhe me sy të lirë
Mesi i Eklipsit	Ndodh në orën:				Mund të vëzhgosh dhe me sy të lirë!
C3	Faza e plotë përfundon në orën:				DUHET të vendosni sërish Filtër-Vrojtuesin Diellor
C4	Faza e pjesshme përfundon në orën:				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
Pas C4	* Eklipsi nuk ndodh *				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor

- 2) Duhet të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor përpara fazës C2 ose pas fazës C3, kur eklipsi nuk është i plotë, ndonëse jeni pozicionuar brenda zonës së plotësisë, për ta vrojtuar Diellin gjatë gjithë kohës.

- 3) Mund ta vëzhgoni Diellin drejtpërdrejt me sy të lirë (pa vendosur Filtër-Vrojtuesin Diellor) VETËM:
 - a. nëse eklipsi është i plotë në vendndodhjen tuaj (ju ndodheni „në zonën e plotësisë“) DHE
 - b. gjatë fazave të plotësisë (afërsisht gjatë periudhës kohore prej C2 në C3 për vendndodhjen tuaj siç është shënuar më sipër) DHE
 - c. **kurdo që disku i shndritshëm i Diellit është TËRËSISHT i mbuluar nga hëna.**

Orët reale kur ndodh plotësia ndryshojnë në bazë të vendndodhjes tuaj të saktë, kështu që duhet të keni identifikuar dhe regjistruar më parë orët e përafërta. Orët e regjistruara janë të përafërta, jo ekzakte!

- 4) Dhe një herë, pavarësisht orëve të shënuara në listën e mësipërme apo të nxjerra nga ndonjë burim i jashtëm, **gjithmonë duhet ta vrojtoni Diellit duke vendosur Filtër-Vrojtuesin Diellor, KURDO QË NDONJË PJESË e diskut të Diellit shfaqet.**
- 5) Këto udhëzime janë të shoqëruara me një shtojcë grafike shpjeguese si ndihmë për t'i kuptuar.

Duhet të lexoni, kuptoni dhe të pajtoheni me deklaratat e mëposhtme:











DUHET TË NDJEK TË GJITHA UDHËZIMET LIDHUR ME PËRDORIMIN E FILTËR-VROJTUESIT DIELLOR, ME QËLLIM QË TA PËRDOR NË MËNYRË TË SIGURTË.

NËSE SHFAQET NDONJË PJESË E SHNDRITSHME E DISKUT TË DIELLIT, DUHET TË PËRDOR FILTËR-VROJTUESIN DIELLOR KUR VËSHTROJ DREJT DIELLIT.

**** EKLIPSI *NUK ËSHTË I PLOTË* PËR VENDNDODHJEN TIME ****

Nuk ndodheni brenda zonës së plotësisë, kështu që nuk do mund ta përjetoni bukurinë e eklipsit të plotë! (Ju këshillojmë fort që të shkoni në një zonë brenda zonës së plotësisë në mënyrë që ta përjetoni këtë eksperiencë të paharrueshme!)

- 1) Bazuar në informacionin e ofruar te faqja eclipse2024.org/find-times për vendndodhjen tuaj ekzakte, shkruajini orët e përafërta për çdo fazë të eklipsit listuar më poshtë (sigurohuni t'i [përshtatni orët](#) me orën lokale të vendit tënd!):

Përpara C1	* Eklipsi nuk ndodh *				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
C1	Faza e pjeshme fillon në orën:				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
Mesi i Eklipsit	Ndodh në orën:				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
C4	Faza e pjeshme përfundon në orën:				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor
Pas C4	* Eklipsi nuk ndodh *				DUHET të vendosni Filtër-Vrojtuesin Diellor



(Nuk ka kohë të shënuar për C2 dhe C3 përderisa eklipsi nuk është i plotë në vendndodhjen tuaj!)

- 2) Përderisa eklipsi nuk është i plotë në zonën ku ndodheni, duhet ta përdorni **GJITHMONË Filtër-Vrojtuesin Diellor**. Përsëri, ju rekomandojmë të shkoni në një vend brenda zonës së plotësisë. Sigurohuni të keni me vete Filtër-Vrojtuesin Diellor, kështu do të mund të vëzhgoni në mënyrë të sigurtë fazat e pjeshme të eklipsit!
- 3) Këto udhëzime janë të shoqëruara me një shtojcë grafike shpjeguese si ndihmë për t'i kuptuar.

Duhet të lexoni, kuptoni dhe të pajtoheni me deklaratën e mëposhtme:

DUHET TË NDJEK TË GJITHA UDHËZIMET LIDHUR ME PËRDORIMIN E FILTËR-VROJTUESIT DIELLOR, ME QËLLIM QË TA PËRDOR NË MËNYRË TË SIGURTË.

DUHET TË PËRDOR **GJITHMONË FILTËR-VROJTUESIN DIELLOR KUR VËSHTROJ DREJT DIELLIT.**



PDF

Shqip

GRAN ECLIPSE NORTEAMERICANO
GRANDE ÉCLIPSE NORD - AMÉRICAINÉ
GREAT NORTH AMERICAN ECLIPSE

